

KULTURA 2022



Nr.2

kultura.gov.al

SHKURT



PREZANTOHET BONUSI I RIJETËSIMIT, GRANTE MBËSHETËSE PËR BANORËT E QENDRAVE HISTORIKE

Ministrja e Kulturës, Elva Margariti po zhvillon një fushatë informimi mbi nismën më të re të Qeverisë Shqiptare, Bonusin e Rijetësimit. Përgjatë muajit shkurt kjo nismë, e cila synon të ruajë trashëgiminë kulturore, të rijetësojë qendrat historike dhe të ndihmojë banorët e këtyre zonave, u prezantua në Gjirokastrë, Krujë dhe Shkodër.

Ministrja Margariti tha se "ky program që nis këtë vit për herë të parë, si nismë e Ministrisë së Kulturës mbështet pronarët të mirëmbajnë dhe rijetësojnë objektet e tyre, banesa e biznese, në qendra historike, ansamble urbane, zona arkeologjike". Gjatë prezantimit në qytetin e Krujës ishte i pranishëm edhe Kryeministri Edi Rama, i cili ndër të tjera u shpreh se "ky program ka një potencial të jashtëzakonshëm dhe kemi gatishmëri që këtë program ta fuqizojmë vit

pas viti duke rritur financimin". "Ftesa ime për të gjithë banorët e këtyre zonave këtu në Krujë, në zonën e kalasë, por jo vetëm,

SYNIMI YNË ËSHTË QË POTENCIALI KULTUROR, TURISTIK, EKONOMIK QË NGËRTHEN KY ANSAMBLË, NJËKOHËSISHT EDHE "ZONË E STIMULUAR" TË RREZATOJË DHE TË REFLEKT

në Berat, Gjirokastrë, Shkodër, kudo ku ka të tilla vlera, të përfshihen dhe të bëjnë atë që na mëson çdo ditë e më shumë rruga e europianizimit dhe integritit në familjen europiane, që paratë, fondet, mbështetja financiare vijnë me ide, projekte, aplikime të be-

sueshme dhe bindëse, nuk vijnë si lëmosha që shpërndahen lart e poshtë", tha kryeministri. Ministrja Margariti vuri në dukje se interesi për t'u bërë pjesë e kësaj nisme, që bën bashkë shtetin dhe privatit, tregon për besimin që qytetarët kanë krijuar në punët e mira dhe konkrete, që prekin në mënyrë direkte mirëqënien e tyre ekonomike.

NDRYSHIME NË LIGJIN PËR TË DREJTAT E AUTORIT, ZGJIDHET ÇËSHTJA E SHPËRBLIMEVE



Pas konsultimeve me grupet e interesit po diskutohet në komisionet parlamentare projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to". Ndryshimet e propozuara vijnë si rrjedhojë e kërkesave të BE për zgjidhjen e disa çështjeve që lidhen me "veprat pa autor" dhe aksesimin të krijimtaria e shkruar e njerëzve me probleme shikimi.

NISIN PUNIMET, KULLA VENECIANE NË DURRËS SHNDËRROHET NË QENDËR INFORMIMI



Kulla Veneciane në Durrës do të shndërron në qendrën e parë bashkëkohore e informimit dhe interpretimit të trashëgimisë kulturore. Punimet për restaurimin dhe rijetësimin e këtij objekti simbolik të trashëgimisë kulturore nisën në 18 shkurt, nën praninë e Ministres së Kulturës, Elva Margariti, Ambasadorit të Bashkimit Europian në Shqipëri, Luigi Soreca dhe përfaqësueses së UNOPS në Tiranë, Pamela Lama.

"PROJEKTET ME THIRRJE", MINISTRIA E KULTURËS

MBËSHETET 185 PROJEKTE

Ministrja e Kulturës mbështet 185 projekte në art, trashëgimi e digitalizim. Pas hapjes së thirrjes për projekte kulturore për vitin 2022, si asnjëherë më parë u depozituan

53%

E PROJEKTEVE FITUESE

JANË PËR PROMOVIMIN E ARTIT DHE KULTURËS PËRMES AKTIVITETEVE

500 projektpropozime, prej nga u përzgjedhën 185 prej tyre, që do të mbështeten financiarisht nga buxheti i këtij viti. Ky është numri më i madh i fituesve, që ka shpallur MK që prej vitit 2014 e që ka një larmishmëri zhanresh, por edhe shtrirjeje gjeografike nga veriu në jug. Ministrja e Kulturës hapi në dhjetor të vitit të kaluar thirrjen për projekte kulturore për vitin 2022. Kjo thirrje synon mbështetjen e projekteve që zhvillohen ekskluzivisht ose kryesisht në Shqipëri.

HIQET BILETA PËR TË VIZITUAR

KALANË E BERATIT

Ministrja e Kulturës heq biletën hyrëse në Kalanë e Beratit, një nga të paktat kala të banuara në vendin



tonë. Ministrja e Kulturës, Elva Margariti u shpreh se vendimi për heqjen e biletës erdhi pas shqetësimit të ngritur nga banorët e Beratit. "Duke iu përgjigjur shqetësimit të banorëve të Beratit, vendosëm të heqim biletën hyrëse në Kala. Tanimë turistë shqiptarë e të huaj mund të shijojnë vizitat e

tyre në një nga zonat më të bukura jo vetëm të qytetit, por gjithë Shqipërinë", deklaroi Ministrja Margariti.

NISIN PUNIMET RESTAURUESË NË MUZEUN ETNOGRAFIK NË KRUIJË

Nisin punimet për restaurimin e Muzeut Etnografik në Krujë, një tjetër objekt i përfshirë në programin e rindërtim-rijetësimin "EU4Culture", mbështetur nga Bashkimi Europian me një shumë prej 40 milionë eurosh, pas tërmetit të vitit 2019. Punimet

500

MIJË EURO ËSHTË KOSTO E RESTAURIMIT TË MUZEUT ETNOGRAFIK

parashikohet të zgjasin 8 muaj dhe kanë një kosto prej 500 mijë euro. Përveç restaurimit të godinës, muzeut nuk do t'i mungojë edhe aspekti digjital, i cili i drejtohet më së shumti brezit të ri, i cili ka nevojë t'i qaset trashëgimisë kulturore përmes gjuhës së kohës, teknologjisë, që ata e njohin më së miri. Muzeu Etnografik në Krujë është një nga 16 sitet e përfshira në listën e "ngushtë" të objekteve me nevoja emergjente ndërhyrjeje restauruese dhe rijetësimi, me një ndikim të dukshëm në jetën e komunitetit.